

MENSUR BIN ABDULAZIZ SIMARI

GJYKIMI ISLAM
NDAJ

LËNIES

SË

NAMAZIT



GJYKIMI ISLAM NDAJ LËNIES SË NAMAZIT

Autor

Mensur bin Abdulaziz Simari

Përktheu

Agron Milazim Krasniqi

Titulli: “Sqarim rreth gjykimit të lënies së namazit”

Titulli në origjinal: "البيان والإيضاح في حكم ترك الصلاة"

Autor: Mensur Simari

Përktheu: Agron Krasniqi

Redaktor fetar: Hariz Allkoçi

Redaktor gjuhësor: Abdurrahim Maxhuni

Ballina: Dorlir Kraja

Botimi i dytë, 1435 h – 2014.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Hyrje

Falënderimi i takon Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamedin, familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij me të mira deri në ditën e gjykimit.

Nuk ka dyshim se namazi është shtylla kryesore mbi të cilën ngrihet feja islame, është lidhja kryesore mes robit dhe Zotit të tij, është gjëja e parë që rob do të pyetet për të para Allahut në ditën e llogarisë, lënësi i tij konsiderohet lënës i fesë, Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) thotë: *"Kush dëshiron të takojë Allahun nesër si musliman le t'i ruajë këto pesë kohë të namazit sa herë që të thirret ezani për to, sepse këto janë rrugët e udhëzimit..."*¹

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka namazi në islam dhe pozita e tij e madhe në fe, dhe për shkak të rrezikut që ka mosfalja e tij për një musliman, vendosa ta përkthej këtë libër i cili sqaron këtë çështje me argumente nga

¹ Transmeton Muslimi në sahihun e tij.

Kur'ani dhe Sunneti dhe mendimi i sahabëve, duke shpresuar që të jetë shkak për udhëzimin e njerëzve dhe ngritje e argumentit për ta.

Duhet ditur se me përkthimin e këtij libri nuk kemi për qëllim nxjerrjen apo largimin e njerëzve nga feja, mirëpo duam t'u sqarojmë muslimanëve të vërtetën në këtë çështje, konform argumenteve, pasi që ne jemi të obliguar të pasojmë argumentin, jo mendimet e njerëzve.

Allahu e shpërbleftë autorin i cili dha leje për përkthimin e librit dhe e pa të arsyeshme të shpërndahej në vendin tonë.

Lus Allahun të na pranojë këtë vepër dhe ta bëjë të dobishme për muslimanët.

O Zoti im udhëzoje popullin tim në rrugën Tënde, bëji ata prej atyre që falin namazin, fali dhe mëshiroji ata, Ti je që udhëzon, falë dhe mëshiron. Amin!

Përkthyesi

Parathënie e botimit të dytë

Falënderimi i takon Allahut i Cili na udhëzoi në adhurimin e Tij, dhe e bëri namazin shenjë të robërve të Tij të dashur, e që namazi është çelës i asaj që posedon robi dhe kapitali i tij, e s'ka fitim kur nuk ka kapital; ka dëshmuar për kufrin (mosbesimin) e lënësit të tij: Kur'ani, Sunneti dhe konsensusi (ixhmau) i sahabëve; dëshmoj se s'ka të adhuruar me meritë përveç Allahut i Cili është i Vetëm dhe i pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, i cili më së miri i është lutur Zotit të tij dhe e ka vërtetuar adhurimin ndaj Tij. Më pastaj:

Ky është botimi i dytë i librit SQARIM RRETH GJYKIMIT TË LËNIES SË NAMAZIT, e paraqes për vëllezërit e mi muslimanë pas një filtrimi dhe shtojce të rëndësishme, e lus Allahun të ketë dobi me të ashtu siç pati me botimin e parë, Ai është i Cili merr përsipër këtë dhe ka mundësi ta bëjë atë.

Shkroi

Mensur bin Abdulaziz Simari

28/06/1421 h

Parathënie e botimit të parë

Falënderimi i takon Allahut i Cili ua bëri obligim namazin besimtarëve për t'iu nënshtruar me të madhështisë së Tij, dhe për t'iu përrulur madhërisë së Tij, dhe për t'u thjeshtësuar para mendjemadhësisë së Tij; nuk ka ardhur nga Ai ndonjë obligim para namazit, e me të vërtetë namazi vazhdon të jetë çelësi i dispozitave të fesë Islame dhe boshti i saj, nuk ndahet nga ajo asnjëherë, nuk ka pasur për Allahun fe pa namaz, vazhdimisht është krahasuar me besimin në fenë e melekëve, peygamberëve dhe gjithë krijesave, ky është obligim gjithëpërfshirës i dispozitave, me të Allahu e fillon përkujtimin e dispozitave tjera, dhe me të i fillon i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) shenjat e Imanit kudo që i përmend ato.

Namazi është nga farzet (obligimet) më të njohura si shenjë e fesë, dhe shenjë dalluese mes muslimanëve dhe idhujtarëve (mushrikëve), nuk e meriton ai i cili hyn në fenë Islame që të jetë prej pasuesve të Islamit dhe ndarjen nga pasuesit e kufrit vetëm se me faljen e namazit.

Allahu e bëri të njohur atë me Ezan i cili thirret për të, për t'i mbledhur njerëzit për faljen e tij, e nëse e lënë atë të

gjithë njerëzit, atëherë fshihet e gjithë shenja e fesë, dhe nuk mbetet në fe shenjë e as gjurmë që të njihet me të.

Namazi është shtylla e fesë e cila nuk ngrihet vetëm se me të, kurdo që të lihet, feja bie, ai është i pari obligim që Allahu e obligoi atë prej adhurimeve, dhe gjëja e parë prej punëve për të cilën llogaritet rob për të, nëse pranohet: mirë, nëse jo: i shkatërrohet e gjithë puna e tij.

Namazi është porosia e fundit me të cilën porositi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ummetin e tij në momentin kur ai po ndahej nga kjo botë. E ai është gjëja e fundit e fesë që humbet, e nëse humbet, humbet e gjithë feja.

Allahu i Madhëruar ua bëri obligim namazin të gjithë Pejgamberëve të mëparshëm, ashtu që i tha Musës (alejhi selam):

﴿ فَاسْتَمِعْ لِمَا يُوحَىٰ ﴿١٣﴾ إِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ

لِذِكْرِي ﴿١٤﴾

{Dëgjo (o Musa) atë që të shpallet, vërtet Unë jam Allahu, s'ka zot që meriton adhurimin pos Meje, më

adhuro vetëm mua dhe fale namazin që të më përkujtosh mua} [Ta Ha: 13,14].

Dhe tregon Allahu për Ibrahimin (alejhi selam) kur ai shkoi bashkë me Ismailin dhe nënën e tij në Mekke duke u lutur:

﴿رَبَّنَا إِنِّي أَسْكَنْتُ مِنْ ذُرِّيَّتِي بِوَادٍ غَيْرِ ذِي زَرْعٍ عِنْدَ مُبَرِّكَ الْمَحْرَمِ رَبَّنَا

لِيُقِيمُوا الصَّلَاةَ

{Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që ta falin namazin...} [Ibrahim: 37].

Dhe përmend Allahu disa nga pejgamberët dhe cilësitë e tyre pastaj thotë:

﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ مِنْ ذُرِّيَةِ آدَمَ وَمِمَّنْ حَمَلْنَا مَعَ نُوحٍ وَمِنْ

ذُرِّيَةِ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْرَءِيلَ وَمِمَّنْ هَدَيْنَا وَاجْتَبَيْنَا إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُ الرَّحْمَنِ خَرُّوا

سُجَّدًا وَبُكِيًّا ﴿٥٨﴾

{Këta (të përmendur) ishin që All-llahu i gradoi nga pejgamberët pasardhës të Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Israilit (Jakubit), dhe prej atyre që i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur; kur u lexoheshin atyre ajetet e Zotit, binin në sexhde dhe qanin}. [Merjem: 58].

Dhe tregon për të gjithë Pejgamberët se ata ishin qe shpejtonin në faljen e namazit, e adhuronin Allahun dhe afroheshin tek Ai me namaz, pastaj thotë:

﴿ خَلَفَ مِنْ بَعْدِهِمْ خَلْفٌ أَضَاعُوا الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهْوَاتِ فَسُوفَ يَلْقَوْنَ عَذَابًا ﴾



{E pas tyre (pejgamberëve) erdhën popuj që e humbën namazin dhe pasuan epshtet e kënaqësitë e tyre, të tillët do të hidhen në Gajja} [Merjem: 59];

Kurse **Gajja** është luginë në xhehennem.

E pejgamberët falnin pesë kohët e namazit në kohën e tyre, sikurse i fali ato Xhibrili (alejhi selam) me të Dërguarin Muhamed (salallahu alejhi ue selem) në ditën e parë në fillim të kohës së namazeve pastaj në ditën e dytë

në fund të kohës së tyre, pastaj tha: ***"O Muhamed: Koha e namazeve është mes këtyre dy kohëve, kjo është koha e namazeve për ty dhe ishte kohë e peygamberëve para teje"***.¹

Pra, nuk ka fe vetëm se me namaz, dhe se argumentet e sheriatit nga Kur'ani, Sunneti dhe konsensusi (ixhmau) i selefëve nga shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) tregojnë për kufrin (mosbesimin) e lënësit të namazit, dhe dalje nga Islami ai i cili e lë atë, dhe sqarimi i kësaj do të jetë sipas kapitujve në vijim:

Kapitulli i parë: Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti.

Kapitulli i dytë: Ixhmau i sahabeve - shokëve të të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem).

Kapitulli i tretë: Dyshime dhe kundërpërgjigje ndaj tyre.

¹ Transmeton Abdurrezaku në Musanef (1/531) Ahmedi në Musned (1/333) ebu Davudi ne Sunen (1/274) Tirmidhiu ne Sunen (1/278-280) Ibn Huzejme në Sahih (1/168) Hakimi në Mustedrek (1/193) nga dy rrugë transmetimi, nga Nafi bin Xhubejr bin Mut'im nga Ibn Abasi radjAllahu anhumata thotë: Ka thënë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem): "Më është bërë imam Xhibrili në Qabe dy herë..." e përmend hadithin e gjatë. Tirmidhiu thotë: hadithi është hasen – sahih, e ka saktësuar gjithashtu Ibn Huzejme, Hakimi dhe Albani, e ky është ashtu siç kanë thënë këta.

Kapitulli i katërt: Përgjigje ndaj argumenteve të kundërshtarëve në këtë çështje.

Kam përmendur në këtë broshurë ato argumente që kam parë se janë më të forta, e ato që nuk kam përmendur ose janë të dobëta në zinxhirë transmetimi ose në argumentim, ose përfshihen në ato argumente që kam përmendur, e prej Allahut të Vetëm kërkoj ndihmë dhe sukses.

Shkroi:

Mensur bin Abdulaziz Simari

Ish-profesor i lëndës së hadithit

Universiteti Islamik në Medine

14/06/1419 h.

KAPITULLI I PARË

Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti

1- Argumenti i parë:

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَوْمَ يُكْشَفُ عَنْ سَاقٍ وَيُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ خَشِعَةً أَبْصَرُهُمْ
تَرْهَقُهُمْ ذِلَّةٌ وَقَدْ كَانُوا يُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ وَهُمْ سَلِيمُونَ﴾

{(Përkujto) Ditën kur kërciri do të zbulohet, e të ashpërsohet çështja deri në kulm (në kijamet), e ata do të ftohen për të bërë sexhde (para Allahut), po nuk mundën. Shikimet e tyre janë të përulura dhe ata i kaplon poshtërimi, kur dihet se ata kanë qenë të ftuar të bëjnë sexhde sa ishin të shëndoshë (e ata - talleshin)). [el-Kalem: 42,43].

Transmetohet në të dy sahihët (Buhariu dhe Muslimi) në hadithin e Ebu Said el-Hudriut ku i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) – e përmend hadithin në të cilin përshkruan gjendjen e njerëzve në Ditën e Gjykimit derisa - thotë:

"...dhe e pason secili popull atë që e ka adhuruar në këtë botë, dhe mbetët vetëm populli im e në të janë edhe munafikët" –derisa thotë-: "dhe e zbulon Allahu i Lartësuar kërcirin (pjesa mes gjurit dhe zogut të këmbës) e Tij të ndershëm dhe nuk mbetët dikush që i ka bërë sexhde Allahut në këtë botë me dëshirë vetëm se i jep leje Allahu të bie në sexhde, dhe nuk mbetet dikush që i ka bërë Allahut sexhde në këtë botë nga frika prej dikujt apo nga syfaqësia vetëm se i ngurtësohet kurrizi e tij dhe nuk ia mundëson Allahu atij të bie në sexhde..."


Kjo është gjendja e munafikëve të cilët kanë bërë sexhde, pra kanë fal namaz në këtë botë me syfaqësi, kurse ditën e gjykimit pengohen dhe nuk u mundësohet të bëjnë sexhde, sepse ata nuk i kanë bërë sexhde Allahut në këtë botë me dëshirën e tyre, e si është puna me atë i cili thirret t'i bëjë sexhde Allahut në këtë botë dhe nuk bën?!!

S'ka dyshim se ky nuk është nga ky ummet (populli musliman) e as prej munafikëve të këtij ummeti, atëherë detyrimisht del që ai është prej jobesimtarëve të cilët kanë shfaqur kufrin (mosbesimin) e tyre, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ ارْكَعُوا لَا يَرْكَعُونَ﴾ (٤٨)

{E kur i thuhet atyre bëni ruku për Allahun, nuk bëjnë ruku} [el-Murselat: 48].

Gjithashtu thotë:



{E kur atyre u lexohet Kur'ani ata nuk bëjnë sexhde}
[Inshikak: 21].

Pra, Allahu e ka bërë namazin shenjë dalluese mes pasuesve të kufrit dhe pasuesve të Islamit, dhe mes pasuesve të nifakut dhe pasuesve të imanit në këtë botë dhe në botën tjetër.

2- Argumenti i dytë:

Allahu i Lartësuar i përshkruan munafikët dhe thotë:

{وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كَسَالَى يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا



{Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t'u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin Allahun}. [en-Nisa: 142].

Transmetohet në sahihun e Muslimit nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ***"Ai është namazi i munafikut, ulet e pret diellin derisa të arrijë mes dy brinjëve të shejtanit (pak para perëndimit), pastaj ngrihet dhe falë katër rekate me shpejtësi dhe nuk e përmend Allahun në to vetëm se pak"***.

Kjo është gjendja e munafikut me namazin!! Kurse ai i cili nuk e pret diellin fare e as nuk falet qoftë edhe me shpejtësi, me qëllim nuk e falë namazin, atëherë ai është jobesimtar i cili e ka shfaq mosbesimin e tij.

3- Argumenti i tretë:

Transmetohet në dy sahihët Buhariu dhe Muslimi në hadithin që e transmeton Ebu Hurejra (radijallahu anhu) se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) e njeh ummetin e tij në ditën e kijametit kur ata vijnë për të pirë ujë te

Haudi¹ i tij, i njeh ata përmes shenjave të ndritshme që kanë në gjymtyrët e tyre për shkak të abdesit, dhe ndërkohë një grup prej tyre dëbohen nga Haudi i tij dhe Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) pyet për ata të cilët dëbohen dhe thotë: **"populli im...! populli im...!"**. I thuhet atij: **"Ti nuk e di se çfarë kanë shpikur (në fe) ata pas teje"**.

Nga ky hadith detyrimisht kuptohet se ai i cili e lë namazin e lë pa dyshim edhe abdesin, dhe se ai i cili e bën këtë nuk njihet nga Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ditën e kijametit dhe ai (salallahu alejhi ue selem) nuk pyet për të, dhe se i tilli me siguri është jobesimtar dhe murted².

4- Argumenti i katërt:

Allahu i Lartësuar thotë duke e qortuar jobesimtarin:



¹ Haudi është liqeni të cilin Allahu i lartësuar ia ka premtuar të Dërguarit Muhamed në xhennet . Sh.p.

² Murted quhet ai njeri i cili ka qenë musliman dhe pastaj ka dalë nga feja islame duke vepruar vepra të caktuara të cilat e bëjnë atë të dalë nga feja, e prej tyre llogaritet edhe mosfalja e namazit sipas argumenteve të cilat i sqaron libri që keni në dorë. Sh.p.

{As nuk ka besuar, e as nuk është falur, mirëpo përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën} [Kijame: 31-32].

Përderisa Islami është: Besim i shpalljes së Allahut dhe nënshtrim ndaj urdhrit të Tij, atëherë e kundërta e tij është: Përgënjeshtrimi dhe kthimi i shpinës ndaj tij, e në ajetin e sipërm: Përgënjeshtrimi është e kundërta e besimit, dhe kthimi i shpinës është lërja e namazit, e ky është ai i prishuri të cilin e përmend Allahu në Kur'an ku thotë:

﴿لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى (15) الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى (16)﴾

{Që aty (zjarr) nuk hyn tjetër, pos atij që është më i prishuri, i cili përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën} [Lejl: 15-16].

Dhe thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَيَنْجَنِبُهَا الْأَشْقَى (11) الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى (12) ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى (13)﴾

﴿ (13)﴾

{Dhe i largohet (përkujtimit) ai i prishuri, i cili do hidhet në zjarr të madh, e pastaj as nuk vdes në të e as nuk mbetet gjallë} [A'la: 11-13].

Pastaj tregon Allahu i Lartësuar për atë që shpëton nga ky zjarr duke thënë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۖ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ۝۱۵﴾

{Ka shpëtuar ai i cili është pastruar, dhe përmend emrin e Zotit të vet dhe falet} [A'la: 14-15], e ai është i cili e vërtetoi fjalën e Allahut me namaz, e kjo është feja e Allahut për të cilën Ai ka dërguar pejgamberë dhe ka zbritur librat, dhe thotë Allahu pas kësaj:

﴿إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ۝۱۸ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ۝۱۹﴾

{Vërtet kjo ka qenë në fletushkat e para, fletushkat e Ibrahimit dhe Musës} [A'la: 18-19].

Pra, nuk mjafton vetëm besimi me zemër pa iu nënshtruar obligimeve të Allahut, ngase Iblisi është kafir me tekst-argument kur'anor, dhe se kufri i tij ishte nga mendjemadhësia e tij dhe nga refuzimi i tij që t'i nënshtrohet urdhrit të Allahut e që ky urdhër ishte: rënia në sexhde Ademit, e nuk ishte kufri i tij me përgënjeshttrim të ndonjë teksti të shpalljes së Allahut.

Gjithashtu Allahu thotë për pabesimtarët:

﴿فَأَنهٖم لَا يَكْذِبُونَ﴾

{Vërtet ata nuk të përgënjeshtrojnë ty...} [En'am: 33].

D.m.th ata besojnë se ti je i vërtetë në atë që thua (vazhdon ajeti):

﴿وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ بِآيَاتِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ﴾

{...mirëpo zullumqarët ajetet e Allahut i refuzojnë (mohojnë)} [En'am: 33], pra nuk i nënshtrohen me vepra fesë së Allahut duke e ditur se ajo është e vërtetë.

Dhe thotë Allahu i Lartësuar për Faraonin dhe popullin e tij:

﴿وَحٰدُوا بِهَا وَاسْتَيْقِنَتْهَا اَنْفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا فَانْظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ

﴿الْمُفْسِدِينَ﴾

{Dhe ata e mohuan atë (besimin që ua prezantoi Musai alejhi selam) mizorisht dhe me kryelartësi, kurse në vetët e tyre ishin të bindur në të} [Neml: 14]. (Pra bindja

e tyre se ajo që solli Musa është e vërtetë nuk u bëri dobi atyre tek Allahu).¹

Dhe thotë i Lartësuar për Jehudët dhe njohjen e tyre që kishin për të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem):

﴿يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ أَبْنَاءَهُمْ^ط﴾

{Ata e njohin atë (Muhamedin) sikurse i njohin bijtë e vet} [el-Bekare: 146].

(Megjithatë nuk iu nënshtuan urdhrave të tij, andaj nuk u bëri dobi njohja që kishin për të).¹

Kështu ishte edhe mosbesimi (kufri) i Ebu Talibit, xhaxhait të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem), ngase ai e dinte shumë mirë se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) ishte i vërtetë në atë që thërriste, dhe Ebu Talibi e pranoi një gjë të tillë dhe e përmendi këtë në poezitë e tij, mirëpo nuk iu nënshtua, andaj nuk i bëri dobi.

Prandaj, këta pabesimtarë nuk hynë në Islam me këtë besim dhe pranim të të vërtetës, sepse ata nuk iu nënshtuan urdhrat të Allahut i cili nuk ngrihet vetëm se me namaz.

¹ Fjala në kllapa është sqarim i përkthyesit.

Dhe thotë i Lartësuari:

﴿ إِنَّمَا يُؤْمِنُ بِآيَاتِنَا الَّذِينَ إِذَا ذُكِّرُوا بِهَا خَرُّوا سُجَّدًا وَسَبَّحُوا بِحَمْدِ

رَبِّهِمْ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿١٥﴾ ﴿

{Vërtet besojnë në argumentet tona ata të cilët kur u përmendën ato bien në sexhde dhe e lartësojnë Atë me falënderim dhe ata nuk bëjnë mendjemadhësi} [es-Sexhde: 15], e nuk tha Allahu për ta se kur u përmendën argumentet tona vetëm i pranojnë ato (me zemër), mirëpo Allahu i veçoi besimtarët duke treguar se ata janë që bëjnë sexhde.

Dhe thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٣١﴾ ﴿

{Dhe faleni namazin e mos u bëni prej mushrikëve} [er-Rum: 31];

Pra, i Lartësuari na tregoi se shenja e të qenurit prej mushrikëve (idhujtarëve) është: lërja e faljes së namazit.

Allahu i Madhëruar ka ashpërsuar kërcënimin për lënësin e namazit, dhe e ka përforcuar këtë gjë përmes gjuhës së

të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) duke e nxjerrë nga imani lënësin e tij, dhe se asnjë farz tjetër prej punëve të robit, nuk është bërë **shenjë ndarëse** në mes **kufrit** dhe **imanit** përveç namazit:

5- Argumenti i pestë:

Nga Xhabir bin Abdullah (radijallahu anhum) transmetohet se ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) të thotë:

"Vërtet mes njeriut dhe mes shirkut e kufrit është: lërja e namazit".¹

6- Argumenti i gjashtë:

Nga Burejdeh bin el-Husajb (radijallahu anhu) transmetohet të ketë thënë: i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

¹ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij (1/88), dhe se i ka përmendur gjerë e gjatë rrugët e këtij hadithi Muhamed bin Nasir el-Mirvezij në librin e tij "Ta'dhim kadri es-Salah" hadithi nr 886 – 892.

"Marrëveshja mes nesh dhe atyre është namazi, kush e lë atë ka bërë kufër (ka mohuar)"¹.

Pra, e ka nxjerrë nga imani (besimi) çdo njërin prej robërve i cili ka bërë marrëveshje në iman nëse e lë namazin, dhe ka qenë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) kur donte ta luftonte ndonjë popull priste derisa të agonte sabahu, e nëse e dëgjonte ezanin, ndalej, e nëse jo atëherë i luftonte ata.²

Kështu vepronte edhe Ebu Bekër es-Siddiku (radijallahu anhu)³. Pra, ky (namazi) është ndër shenjat më të njohura të teuhidit që bëjnë dallim mes pasuesve të **Islamit** dhe pasuesve të **kufrit**.

7- Argumenti i shtatë:

¹ Transmeton Ahmedi (5/346), Tirmidhiu (5/13-14), Nesaiu (1/54), Ibn Maxheh (1/342), Muhamed el-Mirveziu 894-896, Ibn Hibani (3/10), el-Hakim (1/6-7) nga disa rrugë transmetimi nga el-Husejn bin Vakid ky nga Abdullah bin Burejdeh e ky nga babai i tij Burejdeh. Tirmidhiu thotë: hasen sahih, e ka saktësuar gjithashtu Ibn Hibani, el-Hakim dhe el-Albani, kurse hadithi është ashtu siç kanë thënë këta.

² Transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga Enesi radijAllahu anhu.

³ Transmeton Mirveziu, hadithi nr. 873, 874.

Transmetohet në dy sahihët (Buhariu dhe Muslimi) në hadithin e Ubadeh bin es-Samit (radijallahu anhu) ka thënë: *'Na bëri thirrje i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) për t'i dhënë besën atij, dhe nga gjërat që ia dhamë besën atij ishte: Ta dëgjojmë dhe respektojmë kur na pëlqen dhe kur s'na pëlqen, kur jemi në vështirësi dhe në lehtësi (mirëqenje), edhe kur është kundër nesh, dhe të mos i kundërshtojmë prijësit, dhe tha:*

"Përveç nëse shihni kufër të qartë e që për të keni argument nga Allahu".

Transmetohet në sahihun e Muslimit nga Ummu Selemeh (radijallahu anha) se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Do të ketë prijësa, do t'i pranoni disa gjëra (prej tyre) dhe do t'i kundërshtoni në disa tjera, kush i pranon ato të mira është i shfajtuar, kush i kundërshton ata shpëton prej tyre, mirëpo (problemi qëndron tek) ai i cili është i kënaqur dhe i pason ata", i thanë: A të mos i luftojmë ata? Tha: "Jo, përderisa falën".

Po ashtu transmeton Muslimi nga Auf bin Malik (radijallahu anhu) se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Prijësit tuaj më të mirë janë ata që ju i doni dha ata iu duan juve, luten për ju dhe ju luteni për ta; dhe prijësit tuaj më të këqij janë ata që ju i urreni dhe ata iu urrejnë juve, i mallkoni ata dhe ata iu mallkojnë juve" i thanë: O i Dërguari i Allahut, a t'i luftojmë ata me shpatë? Tha: "Jo, përderisa ata falin namazin me ju".

Këto hadithe janë argument se lënia e namazit –për të cilin e kushtëzoi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) luftimin e atyre prijësve- është kufër i qartë që për të kemi argument nga Allahu.

8- Argumenti i tetë:

Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) transmeton se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Koka e kësaj çështjeje është Islami dhe shtylla e saj është namazi....."¹,

¹ Transmeton Ahmedi (5/231), Tirmidhiu (5/12), Ibn Maxheh (2/1312) dhe Muhamed el-Mirvezui nr. 196. Tirmidhiu thotë: hasen sahih. Gjithashtu e transmeton këtë hadith nga një rrugë tjetër: Hannad bin Serijj në ez-Zuhd nr. 1090, el-Mirvezui nr. 197, el-Hakim (2/412-413). Hakimi thotë: hadith i saktë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, është pajtuar me të Dhehebiu, kurse

Pra ashtu sikurse tenda nëse asaj i bie shtylla që ka në mes bie komplet tenda, dhe nuk i bëjnë dobi asaj drunjtë dhe hekurat që ka përreth, dhe se kur ngrihet shtylla e saj atëherë i bënë dobi edhe hekurat dhe drunjtë anësorë; ashtu është edhe namazi në Islam, sikurse në hadithin tjetër nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) thotë:

"Gjëja e parë për të cilën pyetet rob i ditën e gjykimit është namazi i tij, nëse i pranohet namazi, i pranohen të gjitha punët e tjera, e nëse i refuzohet namazi, atëherë i refuzohen të gjitha punët tjera"¹.

Në këtë hadith tregohet gjendja e atij i cili ka falur namaz: ose i pranohet ose i refuzohet, e si është gjendja e atij që nuk falet fare?!!²

Albani thotë: i saktë bashkë me rrugët që ka (es-Sahihah nr. 1122), dhe ashtu është.

¹ Në një transmetim tjetër: *"E para gjë që pyetet rob për të ditën e gjykimit është namazi, nëse është i vlefshëm të gjitha punët do t'i ketë të vlefshme, e nëse e ka të pavlefshëm të tilla do t'i ketë edhe punët tjera"*. Është zgjeruar në shënimin e këtij hadithi dhe zinxhirëve të tij Albani në es-Sahihah nr. 1358, dhe e konsideroi të saktë.

² [**9- Argumenti i nëntë:** Allahu i Lartësuar thotë për mushrikët:

﴿إِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخِذُوا مِنْهُمْ فِي الْيَمِينِ ۖ وَنُفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ﴾



{Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe.} [Teube: 11].

Mënyra e argumentimit në këtë ajet kur'anor: Se Allahu i Lartësuar për vërtetimin e vëllazërisë mes nesh dhe mushrikëve ka vendosur tri kushte:

- të pendohen nga shirku.
- të falin namazin.
- të japin zeqatin.

Nëse ata pendohen nga shirku dhe nuk e falin namazin dhe nuk e japin zeqatin, atëherë ata nuk janë vëllezër me ne. Dhe nëse ata e falin namazin dhe nuk e japin zeqatin nuk janë vëllezër tanë. Kurse vëllazëria në fe nuk humbet përveç nëse del njeriu nga feja krejtësisht, pra nuk humbet me mëkate apo me kufër të vogël...

Nëse thotë dikush: A mendoni se mosdhënia e zeqatit gjithashtu është kufër siç kuptohet nga ky ajet kuranor?

Themi: Për kufrin e lënësit të zeqatit kanë këtë mendim disa dijetarë, e ai është njëri nga mendimet e imam Ahmedit (rahimehullah).

Mirëpo, mendimi më i saktë tek ne është se nuk është kufër, mirëpo personi i tillë dënohet me një dënim të ashpër siç e përmend atë Allahu i Lartësuar në Kur'an dhe Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) në Sunnetin e tij.

Prej këtyre argumenteve është ajo që përmendët në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu) se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) përmendi dënimin e lënësit të zeqatit ku në fund të hadithit thotë:

"...pastaj (pasi të mbarojë dënimi për të) sheh rrugën e tij ose për në xhennet ose për në zjarr..." transmeton Muslimi.

Ky pra është argument se lënësi i zeqatit nuk bën kufër, sepse sikur të ishte kufër nuk do i mundësohej atij rrugë për në xhennet. Andaj thënia e këtij hadithi vendoset para asaj që kuptohet në ajetin e lartcekur nga sureja teube; sepse thënies apo fjalës (mentuk) i jepet përparësi ndaj kuptimit (mefhum) siç është e njohur kjo gjë në shkencën e usulu fikhut].

Pjesa brenda këtyre kllapave [], gjegjësisht argumenti i nëntë, është shkëputur nga libri "Hukm tarik salat" (Gjykimi ndaj lënësit të namazit) faqe 4-5 të shejh Muhamed bin Utthejminit (rahimehullah), ku shejhu ndër argumentet e kufrit të lënësit të namazit përmend edhe këtë. Sh.p.

KAPITULLI I DYTË

Ixhmau (konsensusi) i shokëve të Resulullahut (salallahu alejhi ue selem)

Është transmetuar nga shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) Allahu qoftë i kënaqur me ta, kufri i lënësit të namazit; dhe nuk është transmetuar nga asnjëri prej tyre e kundërta.¹

Transmetohet nga Misver bin Mahrameh dhe Ibn Abasi (radijallahu anhuma), se këta të dy hynë tek Omeri (radijallahu anhu) në momentin kur u godit me thikë derisa ishte në namaz, kaloi një kohë dhe filloi të ndriçohet agimi (sabahu) e Omeri (radijallahu anhu) akoma ishte i alivanosur, filluan ta thërrasin mirëpo vetëdija nuk i kthehej; në këtë moment tha njëri prej të

¹ Përmend Ibn Hazmi (rahimehullah) se është transmetuar kufri i lënësit të namazit nga Omeri, Abdurrahman bin Auf, Muadh bin Xhebeli, Ebu Hurejra dhe të tjerë nga sahabët, dhe nuk dijmë që të ketë prej sahabëve dikush që i ka kundërshtuar ata në këtë mendim. Këtë e ka përmendur edhe Mundhiriu dhe ka shtuar të tjerë nga sahabët si: Abdullah bin Mesudi, Abdullah bin Abasi, Xhabir bin Abdullah dhe Ebu Derda (radijallahu anhum), gjithashtu përveç sahabëve: Ahmed bin Hanbel, Is'hak bin Rahauējhi, Abdullah bin Mubarek, Ibrahim Nehaiu, Hakem bin Utejbēh, Ejub Sihtijani, Ebu Davud Tajalisi, Ebu Beker bin ebi Shejbēh, Zuhejr bin Harb dhe të tjerë. Shiko më gjerë librin e shejh Ibn Uthejmin: Gjykimi ndaj lënësit të namazit. Sh.p.

pranishmëve: Nëse nuk kthjellët atëherë përmendini atij namazin, ata thanë: *Namazi...! namazi...! o prijës i besimtarëve*. Në këtë rast **Omeri** hapi sytë i frikësuar, u kthjellë dhe tha: **"Namazi...! namazi...! po, nuk ka hise në Islam për atë i cili e lë namazin"**, pastaj filloi të falej kurse plaga e tij i pikonte gjak!¹

Transmetohet nga Ebu el-Mulejh el- Hudhelij thotë: E kam dëgjuar **Omerin** (radijallahu anhu) në minber duke thënë: **"Nuk ka Islam ai i cili nuk falet"**².

Kjo është thënia e Omerit (radijallahu anhu) në prezencën e një grup prej shokëve të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) e ata kanë qenë grumbull i madh, e dëgjuan atë dhe asnjëri prej tyre nuk e kundërshtojë atë në këtë thënie.

Transmetohet nga Vehb bin Munebih se ky e pyeti **Xhabir bin Abdullahun** (radijallahu anhuma) dhe i tha: A ka prej namazlinjëve që janë taguta? Tha: **"Jo"**, i tha: A ka prej tyre që janë mushrikë? Tha: **"Jo"**, pastaj më tregoi se e

¹ Ka përmbledhur rrugët e transmetimit të këtij tregimi Imam Muhamed bin Nasr në librin Ta'dhim Kadri es-Salah, hadithi 923-929, dhe ky është tregim i vërtet dhe i njohur.

² Transmeton Mirveziu në Ta'dhim Kadri es-Salah nr. 930, Etheri është i vërtetë.

kishte dëgjuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: **"Mes shirkut dhe kufrit është lërja e namazit"**, pastaj e pyeta: Shokët e të Dërguarit a i konsideronin gjynahet shirk? Tha: **"Allahu na ruajt!!, nuk e konsideronin asnjërin prej namazlinjëve si mushrik"**¹.

Po kështu Ebu Zubejri thotë: Kam dëgjuar Xhabirin (radijallahu anhu) kur u pyet nga një njeri: A e konsideronit ju shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) mëkatin shirk? Tha: **"Jo"**, pastaj e pyeti: çfarë është ajo që ndan mes robit dhe kufrit? Tha: **"Lënia e namazit"**².


Muxhahid bin Xhebr thotë: I thashë **Xhabir bin Abdullahut** (radijallahu anhumu): Cila nga veprat ishte që ndante mes Kufrit dhe Imanit tek ju në kohën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem)? Tha: **"Namazi"**³.

I është thënë Ibn Mes'udit (radijallahu anhu): Vërtet Allahu i Madhëruar shumë po e përmend namazin në Kur'an, sikurse thotë:


¹ Po aty, nr. 889, zinxhiri i transmetimit është i vërtetë.

² Po aty, nr. 947, zinxhiri i transmetimit sipas kushteve të Imam Muslimit.

³ Po aty, nr. 892, zinxhiri i transmetimit është i vërtetë.



{Ata të cilët e falin namazin vazhdimisht} [Mearixh: 23],
dhe thotë:



{Dhe ata janë që namazin e falin rregullisht} [En'am: 92]?

I tha **Ibn Mes'udi**: "**Kjo do të thotë e falin namazin në kohën e tij**". I thanë atij: Ne mendonim o Ebu Abdurrahman se ka për qëllim lënien e tij?!, u tha **Ibn Mes'udi**: "**Lënia e tij është kufër**"¹.

Dhe thotë gjithashtu: "**Kush e lë namazin ai nuk ka fe**"².

Nga **Ebu Derda** (radijallahu anhu) transmetohet se ka thënë: "**Nuk ka iman ai i cili nuk ka namaz**"³.

Nga **Ibn Abasi** (radijallahu anhum) ka thënë: "**Kush e lë namazin ka bërë kufër (ka mohuar)**"⁴.

¹ Transmeton Lalikai në usul el-I'tikad (2/827) dhe Ibn Abdul Berr ne Temhid (4/23), transmetimi është i vërtetë.

² Transmeton Mirveziu nr. 935-937, Etheri është i vërtetë.

³ Po aty, nr. 946, Albani thotë: i vërtetë. Dhe ashtu është.

⁴ Po aty, nr. 939, zinxhiri është i mirë.

Ky është konsensusi (ixhmau) i përcjellë nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) në lidhje me kufrin e lënësit të namazit, i cili konsensus e bën të kotë komentin (te'uilin) e çdo komentuesi.

(Konsensusi (Ixmaw) i përcjellë nga Tabi'inët¹)²

Transmetohet nga **Abdullah bin Shekik** (rahimehullah) (njëri nga tabi'inët e shquar) ka thënë: ***"Shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) nuk e konsideronin lënien e ndonjë veprë kufër, përveç namazit"***³.

Hasan el- Basriu (rahimehullah) thotë: ***Më ka arritur nga shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) thënia e tyre: "Mes robit dhe mes rënies së tij në shirk e të bëjë kufër është: lënia e namazit pa arsye"***⁴.

¹ Tabi'inët janë gjenerata të cilët janë takuar me shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) dhe kanë transmetuar diturinë prej tyre. Sh.p.

² Ky nëntitull nuk gjindet në librin e autorit, e vendosa për ta dalluar nga transmetimet e sahabëve dhe fjalëve të tyre. Sh.p.

³ Transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij (5/14) dhe Mirveziiu në Ta'dhim Kadri es-Salah, nr. 948, e ka saktësuar Albani. Gjithashtu kjo është edhe thënie e Ebu Hurejres (radijallahu anhu), siç transmeton Hakimi nga Abdullah bin Shekik nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu): ***"Shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) nuk e konsideronin lëniën e ndonjë veprë kufër, përveç namazit"***. E saktësoi Hakimi në Mustedrek (1/7), Imam Dhehebiu thotë: zinxhiri i tij është i shëndoshë (salih).

⁴ Transmeton Halali në Sunneh, nr. 1372, dhe Ibn Batah në Ibaneh,

Transmetohet nga **Ejub es- Sihtijani** (rahimehullah) ka thënë: **"Lënia e namazit është kufër nuk ka mospajtim në të"**¹.

Është transmetuar gjithashtu nga tabi'inët dhe ata që janë pas tyre kufri i lënësit të namazit.

Transmetohet nga Ma'kel bin Ubejdilah el-Xhezeri ka thënë: i thashë **Nafiut**²: Një njeri e pranon atë që ka zbritur Allahu i madhëruar (Kur'anin) dhe atë që e ka sqaruar i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) (Sunnetin e tij), pastaj thotë: Po e lë namazin, porse unë e di se ai është i vërtetë dhe obligim nga Allahu?

Nafiu tha: **"I tilli është kafir (jobesimtar)"**, pastaj e tërhoqi dorën e tij nga dora ime i zemëruar dhe shkoi³.

Transmetohet nga **Seid bin Xhubejr** (rahimehullah) ka thënë: **"Kush e lë namazin me qëllim ka bërë kufër"**⁴.

nr. 877, zinxhiri është i vërtetë.

¹ Transmeton Mirveziu, nr. 978, etheri është i vërtetë.

² Tabi'iu i shquar dhe i mirënjohur në transmetimet e shumta të haditheve të vërteta e sidomos nga Abdullah bin Omeri (radijAllahu anhumu). Sh.p.

³ Transmeton Abdullah bin Imam Ahmed në Sunneh (1/382) dhe Mirveziu nr. 977. Etheri është i vërtetë.

⁴ Transmeton Mirveziu, nr. 919.

Nga Jahja bin Main transmetohet të ketë thënë: i është thënë **Abdullah bin Mubarekut**: " 'Ata' po thonë: Kush nuk falet dhe as nuk agjëron pasi që i beson dhe pranon ato, i tilli është besimtar me iman të plotë".

Abdullah bin Mubareku tha: *"Ne nuk themi sikurse thonë 'ata'; (por themi) Ai i cili e lë namazin me qëllim pa arsye derisa t'i kalon koha e tij, i tilli është kafir"*¹. Ka për qëllim me fjalën 'ata': murxhitë².

Është pyetur **Ahmed bin Hanbeli** (rahimehullah) për lënien e namazit me qëllim?

Tha: *"Nuk bën kufër askush me ndonjë mëkat, përveç lënësi i namazit me qëllim, nëse e lë namazin derisa t'i*

¹ Transmeton Mirveziu, nr. 981, etheri është i vërtetë.

² Murxhitë janë grup i devijuar të cilët thonë se Imani është besim me zemër dhe shqiptim me gjuhë, kurse veprat nuk i llogarisin pjesë të Imanit-Besimit. Për këtë arsye nuk e konsiderojnë lënësin e namazit kafir për arsye se sipas tyre namazi është vepër prej veprave të Islamit, dhe se lënia e tij nuk është kufër pasi që vepra tek ata nuk bën pjesë në Iman. Kjo thënie e tyre është në kundërshtim të plotë me Kur'anin, Sunnetin, Ixhmaun dhe fjalët e sahabëve, tabi'inëve dhe dijetarëve të ehli Sunnetit. Sh.p.

***kalojë koha dhe të hyjë koha e namazit tjetër, atëherë ky kërkohet të pendohet tre herë*¹.**

Po ashtu është pyetur **Sadaka bin Fadl** për lënësin e namazit?

Tha: ***"Kafir (jobesimtar)"***².

Ali bin el-Medini (rahimehullah) ka thënë: ***"... dhe lënia e namazit është kufër, nuk ka diç prej veprave që lënia e saj është kufër përveç namazit, kush e lë atë ai është kafir, është lejuar vrasja e tij"***³.

Ebu Abdullah Muhamed bin Nasr el-Mirveziu thotë: Kam dëgjuar Is'hak bin Rahujah të ketë thënë: ***"Është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) se lënësi i namazit është kafir, dhe ky ka qenë mendimi i dijetarëve që prej kohës së të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) deri më sot: se lënësi i namazit pa ndonjë arsye derisa t'i kalojë koha e tij, ai është kafir"***⁴.

¹ Po aty, nr. 982, etheri është i vërtetë, shiko "Mesail mervijeh" nga Imam Ahmedi në Akide (2/36-41) Abdul ilah el-Ahmedi.

² Po aty, nr. 989, etheri është i vërtetë.

³ Transmeton Lalikai në Sherh Usul el-I'tikad, nr. 1752.

⁴ Transmeton Mirveziu në Ta'dhim Kadr es-Salah, nr. 990.

KAPITULLI I TRETË

Dyshime dhe përgjigje ndaj tyre

Dyshimi i parë:

Thënia e disave: Se argumentet që aludojnë në kufrin e lënies së namazit, vlejnë për atë person i cili e lë namazin duke **"mohuar"** obligueshmërinë e tij!!!

Një pretendim i tillë është i kotë në disa aspekte:

I pari: Mendimi i tillë e shfuqizon përshkrimin të cilin e konsideroi Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) dhe për të cilin e kushtëzoi gjykimin mbi lënësin e namazit, pra i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) gjykoj për kufrin e **"lënësit"** të namazit dhe nuk e ka përmendur **"mohuesin"**.

I dyti: Ai që thotë këtë, e konsideroi përshkrimin e lënësit të namazit me diç të cilën i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) nuk e vendosi si përshkrim në gjykim, ngase kush e mohon obligueshmërinë e pesë kohëve të namazit, ai është kafir, edhe nëse i fal ato rregullisht me të gjitha kushtet, shtyllat, obligimet dhe sunnetet e namazeve.

I treti: Nëse komentohet fjala **lënie** me kuptim të fjalës **mohim**, atëherë veçimi i namazit me argumente të

Kur'anit, Sunnetit dhe Ixhmaut të Sahabëve se lënia e tij është kufër nuk ka ndonjë kuptim apo vlerë, sepse ky gjykim (se mohuesi i namazit bën kufër) është i përgjithshëm për të gjitha shtyllat tjera sikurse zekati, agjërimi, haxhi etj.

Pra, kush e lë cilëndo prej tyre duke e mohuar obligueshmërinë e saj ka bërë kufër.

Dyshimi i dytë:

Thënia e disave: se lënia e namazit është kufër amelij (d.m.th kufër i veprës) dhe se kufri i veprës nuk të nxjerr nga feja.

Përgjigje: U themi atyre se kufri i veprës ka prej tij që të nxjerr nga feja sikurse: bërja sexhde për dikë tjetër përveç Allahut, therja kurban për dikë tjetër përveç Allahut, e këto janë kufër i madh që të nxjerr nga feja dhe argument për to është Kur'ani, Sunneti dhe Ixhmai i të parëve të këtij ummeti, gjithashtu edhe lënia e namazit është kufër i veprës i cili e nxjerr nga feja atë që nuk falet siç u sqarua më lartë.

Dyshimi i tretë:

Thënia e disave se: Kufri i cili është përmendur në hadithet e lënësit të namazit është për qëllim kufri i vogël (kufër dune kufër), jo kufri i cili të nxjerr nga feja.

Kjo thënie është e kotë për disa arsye:

E para: Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) e konsideroi lënien e namazit: kufij ndarës mes kufrit dhe imanit, mes besimtarëve dhe jobesimtarëve, duke thënë: ***"Mes robit dhe mes kufrit e shirkut është lënia e namazit"***, dhe ka thënë: ***"Marrëveshja mes nesh dhe atyre (kafirave) është namazi, ai që e lë atë veçse ka bërë kufër"***.

E kufiri është diçka që e ndanë të kufizuarin me diçka tjetër, dhe e bënë atë të dalluar nga tjetri dhe se asnjëri prej tyre nuk futet tek tjetri.

E dyta: Kufri i lënësit të namazit është kufër që të nxjerr nga feja, dhe për këtë tregojnë edhe argumente dhe tekste të tjera siç i përmendëm më herët, për këtë arsye është obligim që të komentohet ky kufër në këtë mënyrë, ashtu që të përputhen argumentet mes vete.

E treta: Konsensusi (ixhmau) i transmetuar nga shokët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) tregon se ata nuk

e konsideronin ndonjë vepër e cila e nxjerr njeriun nga feja përveç namazit.

E katërta: Them i se namazi nuk është sikurse çështjet e tjera, ai është shtylla e dytë e Islamit dhe boshti i tij, është shenjë e muslimanëve me të cilën ata dallohen nga të tjerët; i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) thoshte: ***"Kush fal namazin tonë, drejtohet nga kibla jonë, ha nga e therura jonë, ai është musliman, për të vlen ajo që vlen për ne, dhe obligohet me atë që obligohemi ne"***¹.

Dhe po ashtu ummeti identifikohet nga të tjerët me namaz, kështu që shpesh thuhet: **'Kanë rënë në mospajtim Ehlul Kibleh** (pasuesit e Kibles)' ose **'Kanë rënë në mospajtim Ehlul Salati** (namazlinjë)', po ashtu thënia: **'Nuk e bëjmë kafir askënd nga Ehlul Kibleh'** e kështu me radhë.

Kështu që përshkrimi i lënësit të namazit me kufër, korrespondon me të kufrin i cili e nxjerr atë nga feja².

¹ Transmeton Buhariu nga Enesi (radijallahu anhu).

² Shiko disa nga këto përgjigje në librin e Shejh Muhamed bin Salih el-Uthejmin, me të njëjtin titull.

Dyshimi i katërt:

Thënia e disave se: lënësi i namazit me qëllim, nuk është kafir derisa të vdes në këtë gjendje duke e lënë namazin ashtu që me këtë vërtetohet kufri i tij.

Përgjigje: U thuhet atyre: Nëse ai është kafir me lënien e namazit, atëherë kufri i tij është vërtetuar në momentin kur e ka lënë atë, e kjo është kur i kalon e gjithë koha e namazit të cilën Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë përcaktuar si kohë, dhe janë pajtuar me të të gjithë dijetarët se me kalimin e saj kalon koha e namazit.

Sikurse ai i cili e lë namazin e drekës apo ikindisë derisa të perëndon dielli, ose e lë namazin e akshamit apo të jacisë derisa të lind dielli, pa pasur ndonjë arsye të ligjshme për të; te ky person është vërtetuar se ka lënë namazin¹.

Përndryshe vdekja nuk ka të bëjë asgjë me kufrin apo imanin e një personi, përveç ajo që sqaruar nga vepra e tij.

¹ Shiko (përgjigje të njëjtë me këtë) fjalën e Is'hak bin Rahauējhi (dhe Abdullah bin Mubarek dhe dhe të tjerë nga selefët) më gjerësisht në librin Ta'dhim kadri es-Salat të Muhamed Mirveziut (2/935), po ashtu librin es-Salat të Ibn Kajjimit (26, 27).

KAPITULLI I KATËRT

Përgjigje ndaj argumenteve të kundërshtarëve në këtë çështje

Së pari: Përgjigje e përgjithshme

Themi se argumentet me të cilat argumentohet me to se: lënësi i namazit nuk del nga feja, apo se ai është besimtar; ai që mediton në to i gjen se këto argumente janë tre lloje, të gjitha këto nuk bien në kundërshtim me argumentet të cilat dëshmojnë se lënësi i namazit është kafir.

Lloji i parë:

Ato argumente të cilat në realitet nuk vlejnë të argumentohet me to në këtë çështje, siç është argumentimi i disave me fjalën e Allahut të Madhëruar:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ

فَقَدْ أَفْتَرَىٰ إِثْمًا عَظِيمًا﴾ (٤٨)

{All-llahu nuk falë t'i përshkruhet Atij shok (shirkun), e më pak se ky (mëkat) i falë kujt do.} [Nisa: 48].

Fjala e Allahut: **{e më pak se ky – dune dhalike}** d.m.th diçka më pak se kjo, më pak dhe më poshtë se shirku, e nuk e ka kuptimin: përveç këtij, sepse kush dëshmon La ilahe il-Allah - s'ka të adhuruar me meritë përveç Allahut, e njëson Allahun dhe nuk i bën shirk atij; mirëpo e përgënjeshtrohet Muhamedin (salallahu alejhi ue selem) dhe nuk beson në të si i Dërguar, i tilli me konsensus (ixhma) është kafir dhe nuk i falet atij, megjithatë mëkati i tij nuk konsiderohet shirk.

Gjithashtu edhe lënia e namazit është kufër që nuk falet, dhe se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) e quajti shirk.

Lloji i dytë:

Argumente të përgjithshme të cilat janë shfuqizuar me argumente të veçanta të cilat tregojnë për kufrin e lënësit të namazit, sepse sipas rregullit: *'Argumenti i përveçëm ka përparësi (e shfuqizon, e dobëson) ndaj argumentit të përgjithshëm'*, sepse argumenti i përveçëm është i qartë kurse i përgjithshmi është i pa qartë (i dyshimtë), e në

këtë rast është e domosdoshme bartja e argumentit të paqartë tek ai i cili është i qartë ashtu që të përputhen argumentet mes vete.

Sikurse hadithi i Utban bin Malik se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: **"... vërtet Allahu ia ka bërë haram zjarrin atij i cili thotë: La ilahe il-Allah, dëshiron me këtë fjalë fytyrën e Allahut"**¹.

Po ashtu hadithi i Enesit se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: **"Nuk ka dikush që dëshmon se: 'nuk ka zot që meriton adhurimin me të drejtë pos Allahut (la ilahe il-Allah) dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut', duke qenë i sinqertë nga zemra e tij, vetëm se Allahu ia ka bërë haram atij zjarrin"**², si dhe argumente të tjera të ngjashme, e ky lloj është që më së shumti janë argumentuar me të.

Ajo që e qartëson më shumë rregullin: *bartja e argumenteve të përgjithshme tek të veçantat*, është fakti se çdo kush i cili mohon diçka nga urdhrat e Allahut, apo bën hallall ndonjë ndalesë të Tij, edhe pse dëshmon fjalën 'la ilahe il-Allah Muhamed resulullah', i tilli ka bërë kufër

¹ Mutefekun alejhi.

² Mutefekun alejhi.

me konsensus (ixhma), pra kjo e hedh poshtë argumentimin e tyre me këto argumente të përgjithshme.

Lloji i tretë:

Argumente të cilat janë të kufizuara për ndonjë rast i cili arsyetohet për lënien e namazit, dhe se i tilli në realitet nuk quhet lënës i namazit.

Sikurse rasti i personit i cili përmendet në hadithin e Hudhejfe bin Jemanit (radijallahu anhu) ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) thotë:

"Vazhdon të fshihet (pakësohet) Islami sikurse fshihet ngjyra e rrobës nga larja e shumtë, derisa vjen një kohë nuk dihet ç'është agjërimi, as namazi as haxhi as zekati, dhe ngrihet Libri i Allahut të Madhëruar dhe nuk mbetet në tokë asnjë ajet i tij, dhe mbesin grupe njerëzish ku: plaku dhe plaka të shtyrë në moshë thonë: i kemi gjetur të parët tanë e thoshin këtë fjalë: 'la ilahe il-allah', dhe ne e themi", i tha dikush Hudhejfes: çka mund t'u bëjë dobi atyre fjala ***'la ilahe il-allah'*** kur ata nuk dinë se çka është namazi as agjërimi as haxhi e as zekati?!!, Hudhejfe ia ktheu shpinën dhe nuk iu përgjigj, ia përsëriti pyetjen

tre herë pastaj në të tretën u kthye nga ai dhe i tha: ***"I shpëton ata nga Zjarri"***¹.

Këta njerëz i shpëtoi fjala e teuhidit '*la ilahe il-Allah*' nga zjarri, sepse ata nuk i kishin mësuar obligimet e Islamit dhe nuk dinin asgjë për to, kurse thuhet për dikë lënës i një gjëje nëse atij i ka ardhur urdhri për ta vepruar këtë gjë - e ky nuk e ka vepruar atë -; kurse njerëzit e përmendur në këtë hadith gjëja më e madhe që kishin mundësi ta vepronin ishte kjo, - kishin dëgjuar për këtë fjalë dhe e thoshin atë -, ashtu që gjendja e këtyre është si gjendja e atyre të cilët vdiqën para se të obligohen dispozitat e Islamit (namazi, zekati, etj.), siç është puna e atij i cili ka vdekur në fillim të Islamit.

Ose, sikur ai i cili vdes para se t'i jepet mundësia për të vepruar ndonjë obligim, siç është puna me atë që vdes pasi që ta shqiptojë shehadetin.

Ose, sikurse gjendja e atij i cili vdes para se t'i arrijë atij dituria për këto obligime, siç është puna e atij i cili pranoi Islamin në një vend të kufrit, pastaj vdiq para se të dinte apo t'i arrinin atij obligimet e tjera të Islamit.

¹ Transmeton ibn Maxheh ne Sunenin e tij nr. 4049, dhe Hakimi në Mustedrek (4/473) dhe tha: është i vërtetë sipas kushteve të Muslimit, u pajtua me të Dhehebiu dhe Albani.

Së dyti: Përgjigje në detaje

Do të përmendi këtu vetëm argumentet e vërteta me të cilat janë argumentuar me to në këtë çështje, e në bazë të kësaj krahasohet përgjigja edhe ndaj argumenteve të tjera që nuk janë përmendur këtu:

1- Argumentohen disa me hadithin e Aishes (radijallahu anha) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Betohem për tri gjëra, se Allahu nuk e bënë atë i cili ka pjesë në Islam sikurse atë i cili nuk ka pjesë në të, e pjesët e Islamit janë tri: namazi, zekati dhe agjërimi..."¹.

Mënyra e argumentimit nga ky hadith: Se e konsideroi namazin pjesë prej tri pjesëve të Islamit, pastaj sqaroi se kush e kryen njërin prej këtyre tri pjesëve atëherë atij i takon pjesë apo hise në Islam, kështu që ai i cili e jep vetëm zekatin dhe e lë namazin dhe agjërimin, për të ka pjesë në Islam: d.m.th. ka hise në të, pra nëse do të ishte

¹ Transmeton Ahmedi në Musned (6/145) dhe Hakimi në Mustedrek (1/19), e saktësoi Albani në Sahihah nr. 1387.

lënia e namazit gjë që të nxjerr nga feja atëherë nuk do të kishte për të hise në islam me lënien e tij.

Përgjigje: Nëse robi nuk vjen me këto tri pjesë, dhe i lë të gjitha ato, a ka për të hise në Islam?

Nëse thua: Po, ka hise në Islam, atëherë themi se e prishe kuptimin dhe argumentimin e hadithit të cilën e përmende, ashtu që e bëre të njëjtë atë i cili ka hise me atë që nuk ka hise në të!!

Nëse thua: Jo, nuk ka hise për të, atëherë e bëre tekfir me lënie të namazit, bashkë me lënien e zekatit dhe agjërimin, kurse ne jemi pajtuar se argumentet tregojnë se lënia e zekatit dhe agjërimin nuk është kufër që të nxjerr nga feja; atëherë mbetet shkaku i kufrit të tij lënia e namazit, sepse lënia e tij është lënie e shtyllave të tjera siç aludojnë për këtë argumentet për kufrin e lënësit të namazit, andaj themi se ky hadith është argument për ata që bëjnë tekfir më lënien e namazit!!!

2- Argumentimi i tyre me hadithin e Ebu Hurejres (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Vërtet feja Islami ka simbole dhe shenja sikurse shenjat e rrugës, e prej tyre: të adhurosh Allahun dhe të mos i

***përshkruash shok Atij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, t'i përshëndetësh me selam bijtë e Ademit kur i takon ata, nëse ata ta kthejnë selamin, melekët ua kthejnë ty dhe atij, e nëse ata nuk ta kthejnë selamin, melekët ta kthejnë ty kurse ata i mallkojnë ose heshtin ndaj tyre, e prej shenjave gjithashtu: t'i përshëndetësh me selam familjen tënde kur hyn në shtëpi; kush pakëson apo lë diçka nga këto shenja, ai ka lënë një pjesë nga pjesët e Islamit, e kush i lë të gjitha këto, vetëm se e ka hedh Islamin prapa shpinës së tij (d.m.th. ka dalur nga feja)*^{1. 2}**

Përgjigje: Themi se nëse robi nuk vjen me shenjën e parë prej këtyre shenjave (e që është teuhidi –adhurimi i Allahut dhe lënia e shirkut) a i thuhet atij se ka lënë një shenjë të Islamit apo e ka lënë Islamin në tërësi prapa shpinës së tij (d.m.th ka dalë nga feja)?

¹ Transmeton Mirveziu ne Ta'dhim kadr Salah nr. 405 dhe Hakimi ne Mustedrek (1/21) dhe Ebu Nuajmi në el-Hiljeh (5/217-218), e saktësoi Hakimi dhe Albani në Sahiha nr. 333.

² Mënyra e argumentimit me këtë hadith është fjala e tyre se: hadithi tregon se kush e lë një shenjë nga këto shenja të përmendura në hadith atëherë ai ka lënë mangut një pjesë të Islamit d.m.th. nuk del nga feja, e prej këtyre shenjave është edhe namazi i përmendur në hadith. Sh.p.

S'ka dyshim se ai ka lënë tërë Islamin prapa shpine, sepse argumentet e tjera aludojnë për një gjë të tillë.

Po ashtu u thuhet se kush e lë namazin e ka lënë tërë Islamin prapa shpine, sepse argumentet e tjera aludojnë në këtë siç përmendëm më herët.

Pra, ky hadith është i përgjithshëm, është veçuar me argumente të tjera që tregojnë për kufrin e lënësit të pjesës së parë (teuhidit) dhe të dytë (namazit), dhe se lënia e njërës prej këtyre të dyjave konsiderohet lënie e gjithçkaje tjetër përveç tyre.

3- Argumentimi i tyre me hadithin e Ubadeh bin Samit (radijallahu anhu) transmetohet se ka thënë: Dëshmoj se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: "*Pesë kohët e namazit Allahu ua bëri obligim robërve të Tij, kush e plotëson abdesin mirë dhe i fal ato në kohët e tyre, duke plotësuar mirë rukunë dhe sexhdet e tyre dhe duke u përqendruar mirë në to, për të do të ketë premtim nga Allahu që t'ia fal mëkatet e tij, e kush nuk e bën këtë, për të nuk ka premtim nga Allahu, nëse do e falë e nëse do e dënon*"¹.

¹ Transmeton Maliku në Muvetta (1/133), Ahmedi në Musned (5/315), Ebu Davudi në Sunen nr. 1420, Nesaiu në Sunen nr. 462,

Mënyra e argumentimit të tyre me këtë hadith: Se kush nuk e plotëson mirë abdesin dhe nuk e fal namazin në kohën e tij, nuk plotëson mirë rukunë dhe sexhden dhe përqendrimin në të, i tilli është sikurse ai që e lë namazin, megjithatë Allahu i la atij një shpresë për ta futur në xhennet, ashtu që e la atë nën dëshirën e Tij nëse do e dënon atë e nëse do ia falë atij, e nëse do të ishte kafir nuk do t'i linte atij hapësirë për të shpresuar hyrjen në xhennet.

Përgjigje: Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka bërë dallim mes lënësit të namazit dhe atij i cili lë mangu diç nga dispozitat e tij, kështu që është obligim të dallohet mes tyre në gjykim.

Ka thënë për lënësin e namazit: ***"Mes robit dhe mes shirkut e kufrit është lënia e namazit"***.

Dhe ka thënë për atë që lë mangu dispozitat e namazit në një transmetim tjetër të këtij hadithi e që është shpjegim i hadithit në fjalë, hadithi i Ubadeh bin Samit (radijallahu anhu): ***"... e kush i falë ato (pesë kohët e namazit) duke lënë mangu diç prej tyre duke neglizhuar dispozitat e***

Ibn Maxheh në Sunen (1/448), Mirveziu në Ta'dhim kadr Salah nr. 1029, e saktësoi Albani, dhe hadithi është i vërtetë.

tyre, nuk ka për të premtim nga Allahu, nëse do e dënon atë e nëse do ia falë atij¹.

Ky transmetim deklaroi qartë se ky person ka falur pesë kohët e namazit, mirëpo la mangu dispozitat e tij dhe u tregua neglizhent ndaj tyre, si puna e atij që nuk e plotëson abdesin si duhet, sikurse pastrimi mes gishtërinjve apo moslarja e thembrave të këmbës, e Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) thotë: ***"Mjerë për thembrat që do t'i kaploj zjarri"***², dhe si gjendja e atij që nuk përqendrohet mirë në namaz dhe nuk plotëson mirë rukunë apo sexhden, siç transmetohet në dy sahihët në hadithin e personit që ngutej në namazin e tij, ashtu që u urdhërua që të përqendrohet e qetësohet mirë në namaz; dhe si gjendja e atij që nuk i falë namazet vetëm se pas mbarimit të kohës së caktuar, në kohën e atyre që kanë arsye, kurse ky nuk ka arsye, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) përmendi udhëheqësit të cilët vijnë pas tij, veprojnë atë që u mohohet (vonojnë namazin nga koha e tij), e sahabët i thanë: ***"O i Dërguari i Allahut, a t'i luftojmë ata?"*** Tha: ***"Jo, përderisa falën"***, gjithashtu thotë:

¹ Transmeton Ibn Maxheh (1/448) dhe Mirveziu në T'dhim kadr Salah, nr. 1054, hadithi është i vërtetë.

² Mutefekun alejhi, nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu). Hadithi flet për ata që nuk kishin larë mirë thembrat e këmbëve gjatë abdesit. Sh.p.

"Do të ketë udhëheqës që e vonojnë namazin nga koha e tij, e ju faleni atë në kohën e tij, pastaj faluni me ata namaz vullnetar"¹, pra Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ndaloi që të luftohen ata për derisa falin namazin, dhe sqaroi se ata do ta vonojnë namazin nga koha e tij dhe nuk urdhëroi që të luftohen në këtë gjendje përderisa falën, e kjo aludon se lënia e kujdesit ndaj namazit që të falet në kohën e caktuar nuk është sikurse lënia e tij plotësisht.

Nëse u kuptua dallimi mes dy gjërave, atëherë kuptohet se hadithi i lartpërmendur nënkupton se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) i dha shpresë që të futet në xhennet atij i cili nuk kujdeset si duhet për disa pjesë të namazit siç i cekëm më herët, jo atij i cili e lë namazin plotësisht dhe nuk vjen me asgjë prej tij.

4- Argumentimi i disave me hadithin që transmeton Nasr bin Asim el-Lejthi: ***"se një njeri nga fisi i tij erdhi te Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) që ta pranonte Islamin me kusht që të falte vetëm dy namaze në ditë,***

¹ Transmeton Muslimi në sahihun e tij nga Ebu Dherri (radijallahu anhu) (1/448).

***dhe Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) pranoi këtë gjë nga ai*¹.**

Thanë: Ky hadith tregon se kush lë disa namaze, nuk del nga feja.

Përgjigje: U themi se ky hadith ka të bëjë me një rast të veçantë që nuk mund të përgjithësohet, ky njeri u specifikua me këtë nga sheriati dhe Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) pranoi këtë kusht nga ky, andaj nëse ky person i përmbahet kësaj marrëveshje dhe falë dy namaze në ditë duke u kujdesur për abdesin, plotëson rukunë dhe sexhden, përqendrohet mirë në to, i falë në kohët e tyre, atëherë për këtë ka premtim nga Allahu ta fut në xhennet, ngase pesë kohët e namazit për këtë person janë këto dy namaze në ditë për shkak se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) pranoi këtë nga ai, andaj ky nuk quhet lënës i namazit përveç nëse lë njërin nga këto dy namaze të cilat i janë bërë obligim atij.

5- Argumentohen disa me hadithin e Ebu Said el-Hudriut (radijallahu anhu) nga Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ku në të përmend: "...derisa të dalin besimtarët nga zjarri, pasha Atë që në dorën e Tij është

¹ Transmeton Ahmedî në Musned (5/363), zinxhiri i tij është i vërtetë.

shpirti im, nuk ka dikush prej jush që më shumë i lutet Allahut me këmbëngulje sesa që i luten Allahut atë ditë besimtarët për vëllezërit e tyre të cilët janë në zjarr. Thonë: Zoti ynë, ata ishin që faleshin me ne, agjëronin me ne, kryen haxhin me ne, u thuhet atyre: Nxirrini ata që i njihni, e fytyrat e tyre janë të ndaluara nga djegëja e zjarrit, ashtu që i nxjerrin prej tyre një numër të madh të cilët i kishte përfshirë zjarri deri te zogu i këmbëve, e të tjerë deri te gjunjët e tyre, pastaj thonë (besimtarët): Zoti ynë, nuk mbeti askush prej atyre që na urdhërove t'i nxjerrim. U thotë Allahu: Kthehuni dhe këdo që e gjeni se në zemrën e tij ka ndonjë të mirë sa madhësia e dinarit nxirreni atë. Dhe nxjerrin një numër të madh prej tyre, pastaj thonë: Zoti ynë, nuk lamë asnjë prej atyre që na urdhërove. Pastaj thotë: Kthehuni dhe këdo që gjeni se në zemrën e tij ka ndonjë të mirë sa gjysma e dinarit nxirreni atë. Dhe nxjerrin një numër të madh prej tyre, pastaj thonë: Zoti ynë, nuk lamë në të asnjë prej atyre që na urdhërove, pastaj Allahu u thotë: Kthehuni dhe këdo që gjeni se në zemrën e tij ka të mirë sa grimca atomit nxirreni atë. Dhe nxjerrin një numër të madh, pastaj thonë: Zoti ynë, nuk kemi lënë në të (zjarr) dikë që ka hajr në të.

Dhe Allahu i Madhëruar thotë: Ndërmjetësuan melekët, pejgamberët dhe besimtarët, nuk mbeti vetëm se mëshiruesi i mëshiruesve, dhe kapë një grusht nga zjarri dhe nxjerr njerëz që kurrë nuk kanë punuar asnjë të mirë, të cilët ishin shkrumbuar; i hedh ata në një lumë buzë xhennetit, i thuhet lumi i jetës, dhe dalin nga ky lum sikurse del bima nga toka pjellore,... këta janë të liruarit e Allahut të cilët i futi Allahu në xhennet pa punuar asnjë vepër dhe pa bërë asnjë të mirë..."¹.

Mënyra e argumentimit me këtë hadith: Se Allahu i bëri besimtarët ndërmjetësues për vëllezërit e tyre namazlinjë, agjërues dhe të tjerë në herën e parë, dhe i nxorën nga zjarri duke i njohur ata me shenjë të namazit, kurse kur ndërmjetësuan në herët e tjera dhe nxorën nga zjarri numër të madh prej tyre, nuk kishte prej tyre namazlinjë, mirëpo kishin vepra të tjera të mira secili sipas besimit të tij.

Përgjigje: Themi se hadithi nuk tregon se ata të cilët u ndërmjetësua për ta në herët tjera ishin që nuk faleshin, e as që ata nxorën të gjithë ata të cilët u janë ruajtur fytyrat e tyre nga zjarri (për shkak të sexhdes), ngase shenja e grupit të parë ishte: *'njohja e tyre nga besimtarët në këtë*

¹ Mutefekun alejhi.

dynja se ata faleshin, agjëronin, kryenin haxhin, duke shtuar edhe ruajtjen e fytyrave të tyre nga zjarri, ashtu që i nxorën ata të cilët i kishte kapluar zjarri deri te kocinjët dhe gjunjët', dhe nuk nxorën në herën e parë më shumë se kaq.

Kurse herët e tjera ata ishin prej atyre që nuk i njihnin në këtë dynja me shenjat që u përmendën si namazi, agjërimi, haxhi; ose ishin nga ata që nuk u ka arritur sheriatu kështu që nuk u ka arritur çështja e namazit si gjendja e atyre që i përmendëm në hadithin e "**fshirjes (pakësimit) së Islamit**"¹, kështu që i kaplon zjarri për shkak të ditorisë që kishin e që nuk punuan me të, e Allahu u bëri shenjë besimtarëve për ta në bazë të imanit që kishin në zemrat e tyre që të dallohen me të nga të tjerët.

Ose ata ishin prej atyre që i kaplon zjarri më tepër se sa grupi i parë dhe se nuk mbeti tek ata veçse shenjat e sexhdes, siç transmetohet në një hadith tjetër mutefekun alejhi nga Ebu Hurejra dhe Ebu Said el- Hudriu (radijallahu anhuma), ku thotë: "**... derisa Allahu mbaron gjykimin mes njerëzve, dhe me mëshirën e Tij do t'i nxjerr nga zjarri ata që do, i urdhëron melekët që t'i nxjerrin ata të**

¹ Shiko faqe 22.

cilët nuk i kanë bërë shirk Allahut, prej atyre që Allahu do t'i mëshirojë, të cilët dëshmuar fjalën la ilahe il-Allah, i njohin ata në zjarr përmes shenjave të sexhdes, e zjarri djegë nga biri i Ademit tërë trupin e tij përveç shenjave të sexhdes, sepse Allahu ia ka ndaluar zjarrit t'i djegë pjesët e sexhdes, e këta dalin nga zjarri të shkrumbuar, u hidhet atyre nga uji i jetës dhe mbinë sikurse mbinë fara e hedhur në tokën pjellore, pastaj Allahu i Madhëruar përfundon gjykimin mes robërve dhe mbetet një njeri i kthyer me fytyrë nga zjarri dhe ky është njeriu i fundit i cili hy në xhennet..."¹.

Pra, ata të cilët Allahu i nxjerr nga zjarri prej pasuesve të teuhidit, melekët i njohin ata përmes shenjave të sexhdes derisa edhe i fundit prej tyre që hyn në xhennet.

Andaj, është obligim që ajo që është e paqartë (muteshebih) prej argumenteve të kthehet tek të qartat (muhkem), e këtu kthehet ajo që mund të kuptohet (ihtimal ul-mefhum) në hadithin e parë tek ky hadith i cili potencon në formë të qartë (sarih ul-mentuk).

Kurse argumentimi i tyre me thënien **"nuk kanë punuar kurrë asnjë vepër të mirë (lem ja'melu hajren kat)"** të cekur në hadithin e Ebu Said el-Hudriut (radijallahu anhu),

¹ Mutefekun alejhi.

ky po ashtu është nga argumentet e paqarta (muteshebih), dhe përgjigjja ndaj tij është në dy mënyra me të cilat qartësohet:

Mënyra e parë: themi se vepra e mirë e mohuar në hadith me mohim të përforcuar me fjalën "**kurrë (kat)**" do të thotë se nuk kanë pasur iman fare, atëherë ata janë prej pabesimtarëve!!!

Nëse thonë: Është për qëllim vepra e mirë që vjen pas pranimit të shehadetit, siç tregojnë për këtë hadithet tjera.

U themi: Gjithashtu argumentet e tjera tregojnë se qëllimi në mohimin e veprës së mirë nga ata është ajo çka shtohet pas faljes së namazit, sikurse u përmend në hadithin: "***I fundit nga banorët e xhennetit që hyn në xhennet***" dhe hadithet e kufrit të lënësit të namazit.

Mënyra e dytë: Thënia "***nuk kanë punuar kurrë asnjë vepër të mirë (lem ja'melu hajren kat)***" është përmendur kjo shprehje në hadithe të tjera ku në to qartësohet qëllimi më këtë shprehje dhe kuptimi i saj, e prej tyre: hadithi që tregon për personin i cili vrau 99 njerëz të pafajshëm, pastaj plotësoi 100 duke vrarë njeriun e devotshëm (el-abid), ndërsa dijetari e njoftoi se ka pendim për të, pastaj vdiq para se të arrinte te vendi i

njerëzve të mirë, dhe ranë në kundërshtim në lidhje me të melekët e dënimit dhe mëshirës, ku melekët e dënimit thanë: **"ai nuk ka punuar kurrë asnjë vepër të mirë (lem ja'mel hajren kat)"**, kurse melekët e mëshirës thanë: **"ai u kthye tek Allahu i penduar..."**¹.

Melekët në këtë rast që të gjithë kishin të drejtë në fjalët e tyre në përshkrimin e këtij njeriu, ata nuk gënjejnë e as nuk thyejnë urdhrat e Allahut, andaj nga hadithi kuptohet se melekët e dënimit patën për qëllim me këtë shprehje: se ky njeri e kishte tepruar shumë në mëkate ndaj Allahut në atë masë sa që nuk vlen të përmendën të mirat e tij kundrejt atyre mëkateve, pra ishte i zhytur në mëkate, siç përmendet në një hadith e tjetër ku thuhet: **"se një njeri e kishte tepruar me mëkate"**, në një transmetim tjetër: **"nuk kishte vepruar asnjë të mirë (lem ja'mel hajren kat)"**, porositi familjen e tij: **"kur të vdes më digjni..."**², vazhdon hadithi.

Thënia **"se një njeri e kishte tepruar me mëkate"** në transmetimin e parë është komentim dhe shpjegim i thënies **"nuk kishte vepruar asnjë të mirë"** në transmetimin e dytë, andaj me këtë bëhet e qartë kuptimi i thënies: **"nuk kishin vepruar asnjë të mirë (lem ja'melu**

¹ Mutefekun alejhi.

² Mutefekun alejhi.

hajren kat)", d.m.th.: ata e kishin tepruar ndaj vetes së tyre me mëkate derisa humbën të mirat e tyre kundrejt këtyre mëkateve të shumta, dhe se njerëzit e rëndomtë thonë për ndonjë person i cili nuk e ndalon atë namazi nga veprat e këqija dhe mëkatet derisa bëhet i njohur me këto të këqija të njerëzit, thonë për të: 'filani nuk ka kurrfarë hajri në të'¹.

Nëse i pyet ata: A linte namazin ky person? Do thonë: Jo. Mirëpo ai sikurse mos të falej hiq, kur namazi i tij nuk e ndalon atë nga të këqijat, të ligat dhe padrejtësia që bën.

Me këtë sqarim largohet keqkuptimi dhe dyshimi në këtë hadith.

Gjithashtu thuhet edhe për hadithin e njohur si Hadithi i Kartës (bitakës)², ku mëkatet e këtij njeriu që posedon

¹ Imami i imamëve Ebu Beker Ibn Huzejme (223-311 h) thotë: "Kjo shprehje "lem jamelu hajren kat" (nuk kanë bërë asnjë të mirë) në gjuhën arabe e mohon një diçka për shkak të mangësisë që ka në të, pra nuk është e plotësuar dhe kompletuar si duhet. Thuhet kështu për diçë që nuk e ka punuar veprën në formë të plotë dhe të përkryer, e nuk ka për qëllim atë që ka lënë atë punë që është i obliguar dhe urdhëruar ta bëjë atë". (Kitabu Teuhid të Ibn Huzejme, f. 318). Sh.p.

² Transmeton Ahmed, Tirmidhiu (2639) dhe Hakimi ku edhe e saktësoi atë, nga Abdullah bin Amr bin As se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) thotë: Allahu do ta shpëtojë një njeri nga ummeti

këtë kartë (të shkruar në të *la ilahe il-Allah*) sado të shumta e të llojllojshme të jenë, ato patjetër se nuk përmbajnë shirk të madh, e as ndonjë prej negacioneve të teuhidit (gjëra që e prishin besimin) të cilat prej tyre është edhe lënia e namazit siç treguam nga argumentet e Kur'anit, Sunnetit dhe Ixhmaut të sahabëve Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.


im para të gjitha krijesave në ditën e llogarisë, i sjellin melekët 99 regjistra me mëkatët e tij, ku madhësia e secilit regjistër aq sa shikon syri, pastaj pyetet ky njeri për këto mëkate: a mohon diçka prej tyre? A të kanë bërë padrejtësi shkruajtësit e mi të besueshëm?, thotë: jo o Zoti im, pastaj Allahu i Madhëruar i thotë atij: "A ke arsye për to?, thotë: jo, Allahu i thotë: "Patjetër, ti tek ne ke një të mirë, në këtë ditë nuk ka padrejtësi"; dhe i sjellin atij një kartë të shkruar në të "*la ilahe il-allah muhamed resulullah*", dhe thotë ky njeri: o Zot, e çfarë është kjo kartë para gjithë këtyre regjistrave?! Thotë Allahu: "Ty nuk do të bëhet padrejtësi". Pastaj vendosen regjistrat me mëkate në njërën anë të peshores dhe kjo kartelë në anën tjetër të saj dhe fluturojnë regjistrat dhe rëndon karta; e nuk peshon me emrin e Allahut asgjë."

Ky hadith - siç përmendi edhe autori - personi i përmendur nuk ka në mëkatet e tij mëkat që e nxjerr atë nga feja sikurse shirku apo kufri, e prej tyre edhe lënja e namazit. Po ashtu themi se ky hadith është argument i përgjithshëm dhe nuk tregohet në të se ky njeri nuk falte namaz, andaj nuk mund të merret si argument se lënësi i namazit nuk bën kufër, Allahu e di më mirë. Sh.p.

Përfundim


Namazi është kocka e fesë dhe baza e adhurimit, obligimi i tij ndaj robit nuk bie në asnjë gjendje prej gjendjeve përderisa ai posedon mendje, për dallim nga obligimet e farzet tjera, Allahu e bëri obligim atë për të lirin dhe për robin, për mashkullin dhe femrën, për vendasin dhe udhëtarin, për të shëndoshin dhe të sëmurin, për të pasurin dhe të varfërin, për të riun dhe të vjetrin, për atë që është i sigurt dhe atë që është i frikësuar, në paqe dhe në luftë.

Është prej obligimeve që më së shumti përmendët në Kur'an dhe Sunnet, Allahu e ka veçuar atë nga farzet e tjera ku thotë:



{E për Allahun bëni sexhde dhe adhuroni Atë} [Nexhm: 62].

Pra, namazi është nga simbolet e para që vërteton imanin dhe e dallon miletin (popullin) e imanit nga mileti i kufrit, Allahu i Madhëruar thotë:



{Dhe ji prej atyre që bëjnë sexhde, dhe adhuro Zotin tënd deri në vdekje}. [Hixhr: 98, 99].

Subhaneke allahume ue bihamdike, esh'hedu en la ilahe il-la ente, estagfiruke ue etubu ilejke.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Pejgamberin Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
PARATHËNIE E BOTIMIT TË DYTË.....	5
PARATHËNIE E BOTIMIT TË PARË.....	6
KAPITULLI I PARË	12
ARGUMENTET NGA KUR'ANI DHE SUNNETI	12
ARGUMENTI I PARË:	12
ARGUMENTI I DYTË:.....	14
ARGUMENTI I TRETË:	15
ARGUMENTI I KATËRT:	16
ARGUMENTI I PESTË:.....	22
ARGUMENTI I GJASHTË:	22
ARGUMENTI I SHTATË:	23
ARGUMENTI I TETË:	25
KAPITULLI I DYTË	29
IXHMAI (KONSENSUSI) I SHOKËVE TË RESULULLAHUT (SALALLAHU ALEJHI UE SELEM)	29
(KONSENSUSI (IXHMAU) I PËRCJELLË NGA TABI'INËT)......	34
KAPITULLI I TRETË	38
DYSHIME DHE PËRGJIGJE NDAJ TYRE.....	38
DYSHIMI I PARË:	38
DYSHIMI I DYTË:	39
DYSHIMI I TRETË:	40
DYSHIMI I KATËRT:.....	42
KAPITULLI I KATËRT	43
PËRGJIGJE NDAJ ARGUMENTEVE TË KUNDËRSHTARËVE NË KËTË ÇËSHTJE.....	43
SË PARI: PËRGJIGJE E PËRGJITHSHME	43

LLOJI I PARË I ARGUMENTEVE.....	43
LLOJI I DYTË:.....	44
LLOJI I TRETË:	46
SË DYTË: PËRGJIGJE NË DETAJE:	48
PËRFUNDIM.....	64
PËRMBAJTJA.....	66